

4.

## Fjalë kryesore të fjalës

### Gjymtyrët kryesore të fjalës

#### *Kuptimi i përgjithshëm për fjalën e thjeshtë me dy gjymtyrë kryesore*

Kryefjala dhe kallëzuesi quhen gjymtyrë kryesore, sepse përbëjnë bazën e fjalës; janë qendra organizuese në fjali nga ana ndërtimore, sepse prej tyre zënë fill e lidhen varg gjithë gjymtyrët e tjera. P.sh. *Kënga jonë popullore ka jetuar në shekuj. Hija e rëndë e malit // kishte rënë mbi fshatin e vogël si një perde.* Fjalët e tjera që varen prej kryefjalës dhe kallëzuesit quhen *gjymtyrë të dyta*.

**Fjali e thjeshtë e pazgjeruar** quhet ajo që ka vetëm kryefjalën dhe kallëzuesin, ndërsa

**Fjali e thjeshtë e zgjeruar** quhet ajo që, përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, ka edhe gjymtyrë të dyta.

### 1. Kryefjala

Kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalës dykryegjymtyrëshe, gramatikiqet e pavarur prej gjymtyrëve të tjera, që tregon sendin, frymorin, veprimin, gjendjen a tiparin e cilit tregohet nga kallëzuesi.

Kryefjala ka marrëdhënie kallëzuese me kallëzuesin. U përgjigjet pyetjeve: kush? cili? cila? çfarë? *Aleksandër Moisiu ka qenë artist i madh. Qyteti ynë ka lulishte shumë të bukura.*

Kryefjala shprehet me pjesë të ligjëratës, të cilat, po të jenë të ndryshueshme, vihen në rasën emërore pa parafjalë, ndërsa, po të jenë të pandryshueshme, medoemos do të jenë të emëruara. P.sh.

1. *Me një emër në trajtën e shquar* në rasën emërore pa parafjalë: *Shqiptarët kanë një gjuhë të lashtë.*

2. *Me emër të pashquar.* P.sh.: *Kaluan vite. Në oborr u mblodhën njerëz.* Jashtë fryn erë. Udhëtarëve u pihej ujë. Në kurs erdhi një e re e talentuar. *Rrebeshe* ranë mbi krye të saj.

Kur kryefjala është në shumës të pashquar, mund të shoqërohet me përemra të

pacaktuar dhe numërorë, si: ca, disa, shumë, dy, tre, etj. P.sh. Në konkurs morën pjesë shumë (disa) të rinj.

3. *Kryefjala mund të shprehet me përemra* të çdo lloji, p.sh.: *Ai këndoi disa këngë të reja (vetor). Këta janë krijuesit e rinj (dëftor). Kush i bëri matjet (pyetës)? Nesër do të luajë skuadra që (e cila) fitoi titullin (lidhor). Pas kthesës dikush i thërriste fort (i pacaktuar). Shkolla jonë zuri vendin e parë, juaja të dytën (pronor i emëruar).*

4. *Kryefjala shprehet me çdo pjesë tjetër të emëruar të ligjëratës: Të rejtat këndonin me gjithë shpirt. E vërteta hollohet por s'këputet. Katra është numër çift. Xhaxhait i lindi njëfarë dyshimi.*

5. *Kryefjala mund të shprehet me togefjalësh të lirë ose të qëndrueshëm: Ky djalë, ajo kodër, ca studentë, dy nga shokët, mjaft prej të dhënave, më shumë se gjysma e të rinjve etj., ose kur kallëzuesi është në shumës: Agimi me shokët erdhën të parët. Unë me motrën nuk morëm pjesë në grupin artistik. Një grumbull vajzash kishin dalë te bedenat e kështjellës.*

6. Në veprimet aritmetike kryefjala shprehet me një numëror: *Katër dhe tre bëjnë shtatë.*

### 2. Kallëzuesi

Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalës dykryegjymtyrëshe, që shprehet me folje,

me foljen jam dhe një emër, mbiemër, përemër, numëror ose dhe me një pjesë të pandryshueshme të ligjëratës dhe tregon një veprim, gjendje ose karakteristikë që i referohet kryefjalës, p.sh.: Gjithë natyra buzëqesh nën rrezet e diellit. I sëmuri po dergjet në shtrat. Jeta është një mësuese e madhe.

**Kallëzuesi** u përgjigjet pyetjeve: *ç'bën?, ç'ka bërë?, ç'të bëjë?*

Duke pasur parasysh anën ndërtimore dhe kuptimore të kallëzuesit, dallohen tre tipa:

1. kallëzuesi foljor;
2. kallëzuesi emëror dhe
3. kallëzuesi me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

1. **Kallëzuesi foljor** është dy llojesh:

- **Kallëzuesi i thjeshtë foljor shprehet me një formë foljore të çdo diateze:** Ne *banojmë* në një lagje të Gjakovës. Rruga nuk *kishte zgatur* shumë. Me forma më të ndërlikuara: Mes borës ecte e ecte pa u ndalur. Bariu *s'e la që s'e la* pa gostitur mikun. Me togfjalësha: Mullisi *dha shpirt*. Nuk *e fjete mendje e ta vinte festën mbi sy*. Me forma të pashtjelluar të foljes: *Me të lindur* dielli, karvani u nis për rrugë.

-**Kallëzuesi i përbërë foljor formohet nga dy fjalë kuptimplota, nga të cilat, e para tregon mënyrë veprimi (fillim, mbarim, vazhdim etj) ose modalitet (domosdoshmëri, mundësi, hamendësim), kurse e dyta shpreh veprim:** Lëndinat *nisën të gjallëroheshin* nën rrezet e diellit. Fëmija *vazhdonte të qëndronte* para portës. Vajza *pushoi së qeshuri* dhe kryqëzoi duart. Te njerëzit *duhet krijuar* një mendim i ri demokratik. Uji nuk *mund të arrijë* deri këtu. Uji *sa vinte e shtoej*.

*Fillon e harrohet* pas një kohe. Qiraxhinjtë *zunë e shkojnë*.

2.**Kallëzuesi emëror** përbëhet prej dy pjesësh: prej foljes këpujë *jam* dhe prej **gjymtyrës emërore**. P.sh.: Ne *jemi zotër* të tokave tona. Shqiptarët *janë vendës* këtu që së lashti (me emër). Kjo tokë *është e popullit* (emër në gjinore). Qyteti *ynë është i pastër* (me mbiemër). Rreth e reth *salla ishte me xhama* (emër i prirë me parafjalën me). Unë *s'jam ti*, e ti *s'je unë* (me përemër). Ora *ishte plot dy* pas mesit të natës (me numëror). Ai nuk *ishte as për t'u neveritur* (me paskaljore). Atdhedashuria *është puna e parë* për çdo intelektual (me togfjalësh).

Këpuja mund të mungojë, por nënkuptohet. P.sh.: *Besa besë e fjala fjalë! E bukur Çupa! Punë të thella, moj bijë!*

3.**Kallëzuesi i shprehur me pjesë të tjera të ligjëratës.** Në funksion të kallëzuesit dalin edhe disa pjesëza, pasthirrma, onomatope, që japin idenë e një veprimi ose një vlerësim emocionues të kryefjalës: Djemtë *po se po* por edhe vajzat punonin. Ti ke frikë, unë *jo*. *Lumja* ajo që iu bë djali trim. Kur inatosej, *mjerë* ai që i dilte përpara. Pastaj *bëlldum* në ujë.

### ***Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën***

Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën bëhet në **vetë në numër** dhe në **gjini**.

Përshtatja në **vetë**: Ata *e kanë zgjidhur* mirë këtë problem. Ti *je student i mirë*.

Përshtatja në **numër**: Edhe agronomi, edhe gjeologu *qeshën* nga këto fjalë. Kjo *ndodhi* më shpejt nga se e *kishte menduar* ai me shokët.

Përshtatet në **gjini** gjymtyra emërore (mbiemër ose përemër që ka kategorinë e gjinisë): Lëndinat *janë të bukura* dhe uji *është i ftohtë*.